

Sektori i veprave civile, të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 12.07.2022, në bazë të nenit 28 dhe 32 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi këtë:

M E N D I M J U R I D I K

Në kontestet për shkarkimin e drejtorit të një institucioni, kompetente reale është Gjykata Administrative.

A r s y e t i m

Sipas nenit 3 paragrafi (1) pika 5 të Ligjit për konteste administrative (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr.96/2019), në kontestin administrativ gjykata vendos për ligjshmërinë e akteve të veçanta përfundimtare me të cilat vendoset për zgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin e bartësve të funksioneve publike të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Kryetari i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, organet e administratës shtetërore, organizatat e përcaktuara me ligj, organet tjera shtetërore, si dhe organet e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Sipas nenit 4 paragrafi (1) pika 8 të Ligjit për kontestet administrative, “marrëveshje administrative” është akt dypalësh juridik i lidhur ndërmjet organit publik dhe personit fizik ose juridik lënda e të cilit është kryerja e shërbimit publik ose dhënia e shërbimeve publike qytetarëve me kompetencë të organit publik. Marrëveshje administrative janë marrëveshjet e koncesionit, marrëveshjet për prokurime publike që janë me interes publik, marrëveshjet për kryerjen e shërbimit publik, marrëveshjet për realizimin e punëve publike ose kryerjen e shërbimeve publike me kompetencë të organit publik dhe marrëveshjet tjera që sipas përmbajtjes së lëndës gjykata do t’i caktojë si marrëveshje administrative.

Sipas nenit 2 pika 24 të Ligjit për institucionet (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr.32/05...99/22), marrëveshje administrative është akti dypalësh juridik, me karakter juridik-publik, që lidhet ndërmjet Ministrisë kompetente dhe themeluesit të institucionit, respektivisht personit fizik, i cili veprimtarinë e kryen si veprimtari profesionale.

Sipas nenit 25 paragrafi (4) të Ligjit për institucionet, kontestet që rezultojnë nga dispozitat e marrëveshjes administrative i zgjedh gjykata kompetente sipas Ligjit për konteste administrative.

Sipas nenit 45 paragrafi (1) të Ligjit për institucionet, themeluesi me aktin për themelimin e institucionit mund të parashohë që drejtori i institucionit (një ose më shumë) të emërohet nga anëtarët e organit të qeverisjes. Sipas paragrafit (2), nga i njëjti nen, themeluesi me aktin për themelimin e institucionit mund të parashohë të mos formohet organi i qeverisjes dhe qeverisjen ta ushtrojë drejtori për zgjidhjen e të

cilit shpallet thirrje e hapur në pajtim me nenin 46 të këtij ligji. Sipas paragrafit (3) nga i njëjti nen, themeluesi me aktin për themelimin e institucionit, mund të parashohë që drejtori i institucionit të emërohet në bazë të konkursit publik. Sipas paragrafit (4) nga i njëjti nen, themeluesi me drejtorin nga paragrafi (2) i këtij neni, lidh marrëveshje për menaxhim, e cila ka cilësinë e marrëveshjes administrative.

Sipas nenit 47 paragrafi (3) të Ligjit për institucionet është përcaktuar se kontestet që rezultojnë nga dispozitat e marrëveshjes për menaxhim i vendos gjykata kompetente.

Sipas nenit 31-a paragrafi (1) të Ligjit për kulturë (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.31/98... 11/2018), Ministria e kulturës, në afat prej 15 ditësh nga zgjedhja e drejtorit, me drejtorin e institucionit kombëtar lidh marrëveshje për menaxhim me të cilën rregullohen të drejtat dhe obligimet e Ministrisë së kulturës dhe të drejtorit (në tekstin e mëtejme: marrëveshjes për menaxhim).

Sipas nenit 30 paragrafi (2) pika 9, të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.58/06...96/19), gjykatat themelore me kompetencë themelore janë kompetent të vendosin në shkallë të parë për konteste civile, edhe atë për marrëdhënie pune.

Në rastin kur kërkesa e padisë ka të bëjë me anulimin e vendimit për shkarkimin nga detyra e drejtorit të institucionit kombëtar, bëhet fjalë për anulimin e vendimit që paraqet aktin e veçantë të Ministrisë me të cilin shkarkohet bartësi i funksionit publik. Zgjedhja, emërimi dhe shkarkimi i bartësit të funksionit publik i realizuar nga Kuvendi, Kryetari dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në kundërshtim me kushtet ligjore të një personi të caktuar mund të paraqesë shkeljen e të drejtës, obligimin ose interesin publik të një personi të zgjedhur, të emëruar dhe të shkarkuar ose ndonjë person tjetër.

Duke u nisur nga dispozitat e sipër theksuara, me të cilat është parashikuar se për marrëveshjet administrative, kompetente është Gjykata Administrative dhe vendoset sipas Ligjit për konteste administrative, si dhe se vendimi për shkarkimin e një bartësi të funksionit publik është akt i veçantë i Ministrisë, kjo Gjykatë konstatoi se në kontestet për shkarkimin e drejtorit të Institucionit, kompetente reale është Gjykata Administrative.

Nga e ekspozuara, Sektori i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut e miratoi këtë mendim juridik.

Gjykata Supreme
e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Sektori i veprave civile